



Jurisprudenca islame dhe pershtatja e saj ndaj realitetit shoqëror

## **Description**





## Muhamed Hashim Kemali

Ese e marrë nga periodikja “The Muslim World”, vëllimi LXXXVI, Nr. 1, Janar 1996, f. 62-84.

### Hyrje

Krahas përpjekjes për të ofruar një vështrim të përgjithshëm të *fikh*-ut (jurisprudencës islame), kjo ese formulon edhe një përgjigje ndaj çështjes themelore nëse ka, apo jo, ligji islam kapacitetin dhe burimet e nevojshme për të akomoduar ndryshimin social dhe, nëse po, cilat janë ato. Eseja është e ndarë në tetë pjesë. Dy seksionet e para i japin përgjigje përkufizimit të *fikh*-ut dhe sheriatit, si dhe përvijojnë dallimet kryesore midis tyre. Seksioni i tretë hedh një vështrim të shkurtër mbi historinë e *fikh*-ut dhe kjo pasohet nga një përshkrim i temave kryesore dhe lëndës të kësaj disipline. Seksioni i pestë trajton çështjen e metodologjisë dhe burimeve të *fikh*-ut dhe të formulave që janë krijuar për deduksionin e rregullave të *fikh*-ut. Seksioni vijues zhvillon temën sipas së cilës burimet tekstuale të *fikh*-ut, d.m.th. Kurani dhe Suneti, integrojnë brenda strukturës së ligjeve të tyre njëfarë fleksibiliteti dhe mbeten të hapura ndaj mundësive të interpretimit dhe ixhtihadit (arsyetimit të pavarur). Në seksionin e shtatë diskutohen zhvillimet dhe masat e kohëve të fundit, që janë ndërmarrë për të lehtësuar përdorimin e materialeve burimore të *fikh*-ut. Në këtë seksion përshkruhen, gjithashtu, edhe reformat e kohëve të fundit, të ndërmarra në shumë vende myslimane, që përfaqësojnë zhvillime të reja në *fikh*. Seksioni i fundit orvatet të bëjë një diskutim të shkurtër të *ixhtihad*-it sipas kontekstit të legjislacionit modern dhe eksploron rrugët se si burimet e *fikh*-ut dhe *ixhtihad*-it mund të përdoren në mënyrë më efektive në përpjekjet e vazhdueshme për rindërtimin dhe reformimin e ligjit islam.

### 1. Përkufizim

Fjalë për fjalë “*fikh*” do të thotë njohje ose kuptim, veçanërisht të asaj gjëje që nuk është e vetëkuptueshme dhe kërkon një masë të caktuar ushtrimi intelektual për t’u kuptuar. *Fikhu* është përkufizuar si njohja e rregullave praktike të sheriatit, të cilat deduktohen nga evidenca e tyre e veçantë (*tefsili*) në burimet islame. Burimet e shpallura të sheriatit, gjegjësisht Kurani dhe Suneti, ofrojnë evidencën themelore nga e cila, përmes aplikimit të arsyetimit juridik dhe *ixhtihad*-it, deduktohen rregullat e *fikh*-ut. Përdorimi i arsyetimit si parakusht përjashton njohjen e rregullave të qarta të sheriatit, të tilla si numri i faljeve ditore, nga fusha e veprimit të *fikh*-ut. Ai shmang gjithashtu, edhe dijen e shpallur, si p.sh. dijen e profetit, si edhe dijen e një imituesi të plotë (*mukalid*), e cila nuk përfshin kuptimin përmes jetësimit të arsyes.

Të thuash se *fikh*-u shqyrton rregullat praktike të sheriatit do të thotë se rregullat e *fikh*-ut lidhen me sjelljen dhe aktivitetet e përditshme të individit dhe kjo do të përjashtonte nga përkufizimi i *fikh*-ut, për shembull, dijen e teologjisë dogmatike (usul el-din) si edhe dijen e metodologjisë dhe burimeve të *fikh*-ut (*usul el-fikh*), nga përkufizimi i *fikh*-ut. Aspektet e situatave praktike të sjelljes vlerësohen sipas një shkalle prej pesë vlerash që shkojnë nga ato të obligueshme (*vaxhib*) në ato të këshillueshme (*mendub*), të lejueshme (*mubah*), të qortueshme (*mekruh*) dhe të ndaluara (*haram*). Të thuash se rregullat praktike të *fikh*-ut deduktohen nga materialet burimore të sheriatit do të thotë se rregullat e *fikhut* nuk mund të merren nga burimet joshariatike, të tilla si matematika dhe historia. Të deduktuarit e rregullave të *fikh*-ut nga evidencat e hollësishme që gjenden tek burimet islame nënkupton, gjithashtu, kontaktin e drejtpërdrejtë me materialet burimore të sheriatit dhe me aftësinë për të kryer *ixhtihadin*. Kur një *fakih* (dikush i cili është i ditur në *fikh*) përmbush kërkesat e këtij përkufizimi, sipas dijetarëve të *usul fikhut* ai ose ajo është një *muxhtehid* (dikush i cili është i aftë të bëjë *ixhtihad*). Dijetarët e *usulit* kanë vënë shenjën e barazimit midis *fakihut* dhe *muxhtehidit*. Nga ana tjetër, dijetarët e *fikhut* përfshijnë në përkufizimin e *fakihut* atë person që përfiton diturinë e rregullave praktike të sheriatit, madje edhe pa aftësinë për t’i deduktuar ato drejtpërdrejt nga burimet islame.[1]

### 1. Sheriati dhe Fikhu

---

Shpesh termi sheriat përdoret në mënyrë të ndërkëmbyeshme me *fikhun*. Sidoqoftë, midis tyre ekzistojnë dallime që shpesh nuk janë marrë parasysh. Siç mund të shihet nga përkufizimi i *fikhut*, kjo lëmi është një dije e rrjedhur që e përfiton thelbin e saj nga sheriatit. Meqenëse *fikhu* konsiston në njohjen e rregullave praktike të sheriatit, kjo lëmi është e lidhur ngushtë me sheriatin. Sheriatit i referohet si ligji i Allahut, ndërsa *fikhu* i referohet si ligji i njerëzimit.

**Date Created**

16/10/2014

**Author**

erasmusi